

PRISHTINA



KOMUNA E PRISHTINËS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT
STRATEGJIK DHE ZHVILLIMIT
TË QËNDRUESHEM

PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM PËR TËRËSINË URBANE “B” TË LAGJES
PRISHTINA E RE – ZONA LINDJE NË PRISHTINË 2017-2025

PRISHTINË

SHTATOR 2017

PRISHTINA



KOMUNA E PRISHTINËS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHEM

**PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM PËR TËRËSINË URBANE “B” TË “LAGJES
PRISHTINA E RE – ZONA LINDJE” NË PRISHTINË 2017-2025**

KOMUNA E PRISHTINËS:

Kryetar: **z. Shpend Ahmeti**

.....

Drejt看: **z. Genc Bashota**

.....

Kryesues i Kuvendit: **z. Halim Halimi**

.....

PËRMBAJTJA

TOPOGRAFIA	12
KARAKTERISTIKAT E NDËRTIMEVE EKZISTUESE	14
TRAFIKU	15
INFRASTRUKTURA	15
GJENDJA E PROPOZUAR	16
PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM – ELEMENTE TË PËRGJITHSHME	17
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	17
EMRI I PLANIT	17
BAZA LIGJORE PËR PLANIN	17
ELEMENTET IDENTIFIKUESE TË PLANIT	17
KUFIRI I PLANIT	17
SIPËRFAQJA E PLANIT	17
PARCELAT KADASTRALE BRENDË KUFIRIT TË HAPËSIRËS QË TRAJTOHET	17
POPULLSIA DHE BANIMI	19
INSTITUCIONET PUBLIKE	19
STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR	20
DESTINIMI I SIPËRFAQEVE	20
RREGULLAT URBANE DHE MËNYRAT E PËRTËRIRJES SË GJENDJES EKZISTUESE	22
BANIMI	22
KONCEPTI I HAPËSIRAVE PËRRETH NDËRTESAVE	23
KUSHTET URBANE DHE SIPËRFAQET PUBLIKE, PRIVATE SI DHE ELEMENTE PËRCJELLËSE	24
VIJAT RREGULLUESE TË RRUGËVE DHE SIPËRFAQEVE PUBLIKE SI DHE VIJAT E NDËRTIMIT	26
PIKAT E LARTËSISË (KUOTAT) SE RRUGËVE DHE SIPËRFAQEVE PUBLIKE (PLANI I NIVELIMIT)	26
ZGJIDHJA E RRJETIT TË INFRASTRUKTURËS: RRUGËT, FURNIZIMI ME UJË, UJËRAT E ZEZA, UJËRAT ATMOSFERIKE, TELEKOMUNIKIMET, ELEKTRICITETI, ETJ. SI DHE KYÇJET NË INFRASTRUKTURË	27
TRANSPORTI PUBLIK	27
INFRASTRUKTURA RRUGORE	27
KATEGORITË E RRUGËVE	28
RRUGËT PËRMBLEDHËSE	29
RRUGËT TJERA	29
ECJA DHE ÇIKLIZMI	29

PLANI I PARCELIMIT DHE I RIPARCELIMIT TË PROPOZUAR	29
PLANI I ZBATIMIT	30
BASHKËPRONËSIA	30
NORMAT DHE STANDARDET TEKNIKE PËR ZHVILLIMIN URBAN DUKE PËRFSHIRË SHKALLËN E PLANEVE	31
KUSHTET DHE KRITERET PËR MBROJTJEN MJEDISORE	31
KUSHTET DHE KRITERET PËR SHFRYTËZIMIN RACIONAL TË ENERGJISË	31
KUSHTET NË LIDHJE ME MBROJTJEN MJEDISORE NGA LLOJE TË NDRYSHME TË NDOTJES, MBROJTJA E BIODIVERSITETIT, MBROJTJA NGA ZJARRI DHE FATKEQËSITË E TJERA SI DHE SHKATËRRIMET	32
RUAJTJA E AJRIT	32
RUAJTJA E TOKËS	32
RUAJTJA E UJIT	32
MBROJTJA NGA ZHURMA	32
MBROJTJA NGA ZJARRI DHE FATKEQËSITË E TJERA	32
POZITA E NDËRTESES NË PARCELË DHE NË KUADER TË PARCELAVE FQINJE DHE DISTANCA MË E VOGËL NDËRMJET NDËRTESAVE	33
LARTËSIA E NDËRTESAVE	34
KUSHTET PËR NDËRTIMIN E NDËRTESAVE TË TJERA NË PARCELËN E NJEJTË NDËRTIMORE	34
KUSHTET DHE MËNYRAT E SIGURIMIT TË HYRJES NË PARCELË DHE NË HAPËSIRËN E PARKIMIT	34
PARKIMI DHE GARAZHIMI	34
DEPONIMI I MBETURINAVE	35
KUSHTET PËR DEFINIMIN E RRETHOJAVE	35
FORMËSIMI ARKITEKTONIK DHE ESTETIK I ELEMENTEVE TË CAKTUARA TË NDËRTESES	35
JO KONFORMITET, PËRJASHTIMET	35
KUSHTET PËR RENOVIM DHE RIKONSTRUIM TË NDËRTESAVE EKZISTUESE	36
KUSHTET PËR VENDOSJEN E NDËRTESAVE TREGTARE, DEPOVE APO FABRIKAVE	36
KUSHTET PËR NDËRTIMIN E NDËRTESAVE ME RËNDËSI STRATEGJIKE	36
VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR	36
INSTALIMET ELEKTRIKE	37
INSTALIMET MAKINERIKE	48
RRRJETI I UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT	53

PËRMBAJTJA E PJESËS GRAFIKE

Figure 1. Kufiri i Planit	10
Figure 2. Inçizimi Gjeodezik	11
Figure 3. Zona e fotografuar në fillim të vitit 2017	12
Figure 4. Zona efotografuar në fillim të vitit 2017	12
Figure 5. Parcelat Kadastrale që Përfshihen në Plan	16
Figure 6. Riparcelimi i Propozuar	19
Figure 7. Destinimi i Sipërfaqeve	22
Figure 8. Plani i Nivelimit	23
Figure 9. Infrastruktura Rrugore	24
Figure 10. Profili i Rrugëve	25

DEFINICIONET

Është toka e parashikuar për ndërtimin e ndërtesave të përfshira me plan, që përbëhet nga një ose më shumë parcela kadastrale ose pjesë të tyre;	Parcela ndërtimore
Është vendi, në të cilin kryhen punimet ndërtimore në përputhje me planin e caktuar ose me aktin tjetër të nxjerrë në bazë të këtij ligji;	Lokacioni
Parcela kadastrale paraqet sipërfaqe të përkufizuar të tokës e identifikuar me numër të parcelës dhe e regjistruar në hartën kadastrale me sipërfaqe reale në projeksionin hartografik dhe sipërfaqe të regjistruar në RDPP-ë (Ligji nr. 04/L-013 për Kadastër);	Parcelat kadastrale
Vlerësimi Strategjik Mjedisor;	VSM
Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës;	PZhK
Plani Zhvillimor Urban “Prishtina 2012-2024”;	PZhU
Plani Rregullues Urban “Prishtina e Re – Zona Lindje”;	PRrU
Qendra e Mjekësisë Familjare;	QMF
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës-përqindja e sipërfaqes nëntokësore të shfrytëzueshme në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale për zhvillim;	SNP
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës kadastrale për Zhvillim – paraqet raportin në mes sipërfaqes së shputës së ndërtesës dhe sipërfaqes së parcelës kadastrale për zhvillim, shumëzuar me numrin 100;	ISHPKZh
Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar – Raporti në mes të sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit Brenda parcelës kadastrale dhe sipërfaqes kadastrale për zhvillim;	ISN
Vija Rregulluese – paraqet largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale të paraparë për ndërtimin e infrastrukturës teknike, në të cilin nuk lejohet asnjë lloj ndërtimi;	VRR
Vija ndërtimore – paraqet largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale dhe vija rregulluese në të cilën lejohet ndërtimi i sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme;	VN

Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës;

PZhK

Kati i cili gjendët nën përdhese, ku së paku 50%, e vëllimit të tij është mbi nivelin e tokës apo njëra ballore tij është mbi nivelin e tokës;

Suteren

Kati i cili gjendët nën përdhese, apo suteren ku më shumë se 50%, e vëllimit të tij është i futur nën nivelin e tokës.

Bodrum

PËRMBLEDHJE PROCEDURASH TË ZHVILLUARA GJATË PROCESIT TË HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR TËRËSINË URBANE “B” TË LAGJES PRISHTINA E RE - ZONA LINDJE NË PRISHTINË 2017-2025

1. Kërkesa e qytetarëve, përkatësisht pronarëve të tokave drejtuar Komunës së Prishtinës, për ndërtimin e tërësisë urbane “B” në lagjen Prishtina e Re - Zona Lindje.

2. Nevoja për hartimin e një Plani Rregullues të Hollësishëm për këtë zonë ka ardhur pas analizës së hollësishme të planeve aktuale dhe mos përputhjes së tyre, jo vetëm në strukturën urbane mirëpo edhe në infrastrukturën e planifikuar rrugore, gjegjësisht banimi individual sipas Planit Rregullues aktual është i shtrirë në luginën e përroit me ç’rast implementimi i këtij plani është i pa mundshëm, po ashtu infrastruktura rrugore e planifikuar nuk është e bazuar në gjendjen faktike të terrenit ku sipas kësaj, realizimi i infrastrukturës paraqet një sfidë të madhe për Komunën e Prishtinës.

3. Plani Rregullues i Hollësishëm ka caktuar kushtet ndërtimore sipas ligjit për Planifikim Hapësinor 04/L-174 dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi elementet themelore të Planit Rregullues me nr.41, 02/05 (bazuar në interpretimet e dhëna nga MMPH-ja) dhe Udhëzimin Administrativ MMPH-nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

4. Plani gjithashtu përmban të gjitha elementet të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Plane Rregulluese të Hollësishme – draft.

GJENDJA EKZISTUESE

HAPËSIRA QË PËRFSHINË PLANI

Hapësira që përfshinë plani ndodhet në pjesën jug-lindore të qytetit të Prishtinës, përkatësisht në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban 2012-2022 të Komunës së Prishtinës si dhe në Pjesën Lindore të Planit Rregullues “Prishtina e Re”.

Plani Rregullues i Hollësishëm për Tërësinë urbane “B” të - Lagjes Prishtina e Re-Zona Lindje, në pjesën veriore kufizohet me tërësinë urbane “A” të PRrU “Prishtina e Re-Zona Lindje”, në pjesën veri-lindore me fshatin Zllatar, në jug-lindje me liqenin e Badovcit, në pjesën perëndimore me PRrU “Prishtinës së Re-Zona Qendër”, në pjesën jugore tangjenton unazën e jashtme të qytetit dhe ndërlidhet me fshatin Hajvali.

Zona e planit e përcaktuar për ndërtim ka sipërfaqe prej 109.72 Ha.

Në të gjitha anët e zonës që e rrethojnë planin, kemi të bëjmë me pjesë periferike të qytetit përkatësisht hapësira gjelbëruese dhe bujqësore.




Figure 1. Kufiri i Planit

TOPOGRAFIA

Zona shtrihet në lartësi mbidetare rreth 700-800m. Terreni ka pjerrtësi 6% - 10% nga pika më e lartë në lindje e deri te kufiri në perëndim. Pjesa qendrore e planit përfshinë bregun e përroit që shtrihet në drejtimin lindje – perëndim, ku terreni ulet deri në pikë të lartësisë 705 m.m.d.

Kemi të bëjmë me një hapësirë që ofron pamje interesante drejt qytetit, pra hapësirë me shumë rëndësi dhe delikate, pasi që ndërhyrjet e reja hapësinore do të duken nga ana e liqenit të Badovcit.




Figure 2. Inçizimi Gjeodezik

KARAKTERISTIKAT TJERA NATYRORE

Në pjesën qendrore të planit kemi të bëjmë me një shtrat lumi (në lindje e perëndim) jo të bujshëm që ka nivel të ulët të ujit gjatë periudhave me reshje por për periudhën më të gjatë të vitit kryesisht është i tharë. Në luginën e përroit ka mjaft vegjetacion të ulët, kryesisht i mbirë në mënyra natyrale, gjithashtu gjelbërim të ulët ka edhe në hapësirën tjetër të planit. Vegjetacion të lartë në zonën e planit thuajse nuk ka. Sipas Ligjit me nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, nuk ka vegjetacion që duhet mbrojtur, poashtu nuk është identifikuar ndonjë monument i trashëgimisë kulturore.



Figure 3. Zona e fotografuar në fillim të vitit 2017

KARAKTERISTIKAT E NDËRTIMEVE EKZISTUESE

Hapësira e zonës nuk ka ndërtime ekzistuese. Ndërtime të rralla mund të hasim në zonat përreth.



Figure 4. Zona e fotografuar në fillim të vitit 2017

TRAFIKU

Në zonë nuk kalon asnjë rrugë e ndërtuar. Sipas PZhU-së në jug të zonës është e planifikuar unaza e jashtme e qytetit dhe në veri të zonës unaza e brendshme e qytetit që ofrojnë lidhje funksionale me qendrën e qytetit si dhe me rrjetin regjional të rrugëve. Shtigje për çiklistë në këtë zonë nuk ka.

Nuk ekziston transporti publik.

INFRASTRUKTURA

Meqenëse zona në fjalë është zonë tërësisht e pa ndërtuar edhe rrjeti i infrastrukturës teknike mungon.

GJENDJA E PROPOZUAR

PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM – ELEMENTE TË PËRGJITHSHME

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

EMRI I PLANIT

Emri i planit është Plani Rregullues i Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B”

të lagjes Prishtina e Re – Zona Lindje në Prishtinë 2017-2025, në vazhdim të tekstit: Plani.

BAZA LIGJORE PËR PLANIN

Plani Rregullues i Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të lagjes Prishtina e Re – Zona Lindje në Prishtinë 2017-2025, është i bazuar në:

- *Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor*, nr. 04/L-174;
- *Ligjin për Ndërtimin*, nr.04L/-110;
- *Udhëzimin Administrativ nr. 02/05, për zbatimin e ligjit për planifikim hapësinor mbi elementet themelore të planit rregullues urban*;
- *Udhëzuesi Administrativ nr.05/2014, mbi procedurën e shqyrtimit publik për Planet Hapësinore*;
- *Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës*, në vazhdim të tekstit: PZhK;
- *Plani Zhvillimor Urban “Prishtina 2012-2024”*, në vazhdim të tekstit: PZhU;
- *Plani Rregullues Urban “Prishtina e Re – Zona Lindje” (2013)*, në vazhdim të tekstit: PRrU.
- *Udhëzimin Administrativ MMPH-nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor*.

ELEMENTET IDENTIFIKUESE TË PLANIT

KUFIRI I PLANIT

Kufiri i planit është i paraqitur në pjesën grafike “Kufijtë e hapësirës që trajtohet”, P=1:25000, dhe është i përcaktuar nga kufijtë e parcelave kadastrale dhe rrugët që e rrethojnë atë.

SIPËRFAQJA E PLANIT

Plani përfshinë sipërfaqe prej 109.72 Ha.

PARCELAT KADASTRALE BRENDË KUFIRIT TË HAPËSIRËS QË TRAJTOHET

Zona Kadastrale Matiçan:

1390-0,9000-9, 1392-0, 1386-0, 1421-0, 1384-0, 1385-0, 1374-0, 1398-0, 1399-0, 1397-0, 1402-0, 1404-0, 1403-0, 1393-0, 1400-0, 1395-0, 1394-0, 1401-0, 1381-0, 1380-0, 1405-0, 1396-0, 1383-0, 1382-0, 1420-0, 1367-0, 1361-0.

Zona Kadastrale Hajvali:

28-2, 22-0, 0019-0, 002-1, 001-1, 005-0, 004-1, 1239-2, 1239-1, 0516-2, 0023-0, 0026-0, 0024-0, 0025-0, 004-2, 0059-0, 0028-1, 0027-0, 0058-0, 0062-0, 0065-0, 0064-0, 0063-0, 0057-0, 0056-0, 1217-0.

Zona Kadastrale Zllatar:

466-0, 459-0, 584-0, 616-0, 467-0, 468-0, 469-0, 470-0, 583-0, 557-0, 472-0, 474-0, 475-0.




Figure 5. Parcelat Kadastrale që Përfshihen në Plan

Sa i përket pronësisë së këtyre parcelave janë identifikuar Parcela me pronësi Republika e Kosovës, P.Sh. Kuvendi Komunal, Private dhe parcela 19-0 ZK. Hajvali dhe 9000-9 ZK. Matiqan në sistemin Kadastral figurojnë si parcela që nuk kanë të dhëna për t'u paraqitur.



Figure 6. Pronësia

POPULLSIA DHE BANIMI

Plani Rregullues i Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të lagjes Prishtina e Re – Lindje është i dedikuar për njeriun. Prioritet i është dhënë këmbësorëve dhe çiklistëve, si dhe është mundësuar qasje e lehtë në parking. Rrugët dhe hapësirat e hapura janë të projektuara në atë mënyrë që të shfrytëzohen sa më mirë nga banorët, për ecje dhe rekreacion.

Në bazë të zhvillimeve të reja në lokacion, marrë për bazë sipërfaqen e banimit dhe katin në Planin Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të lagjes Prishtina e Re – Lindje numri i parashikuar i banorëve mund të jetë rreth 21 000.

Llogaritjet lidhur me numrin e popullsisë janë bërë duke u bazuar në dendësinë banimore dhe koeficientin e lejuar sipas PZHU – Prishtina 2012-2022, si dhe UA 08/2017 për normat teknike të planifikimit.

INSTITUCIONET PUBLIKE

Në bazë të planit dhe standardeve për zhvillim të shëndoshë të komunitetit parashihen shërbimet themelore si:


- 1.2.1. Nëntë institucione parashkollore, pesë prej të cilave duhet të jenë në pronësi publike, që mund të ndërtohen mbi një sipërfaqe territoriale rreth 15,000 m² [1.5 ha] d.m.th 3,000 m² [0.3 ha] për një institucion parashkollorë;
- 1.2.2. Tri institucione të edukimit fillor shkollë e mesme e ulët, që mund të ndërtohen mbi një sipërfaqe territoriale prej 30,000 m² [3 ha] d.m.th 10,000 m² [1 ha] për një institucion të edukimit fillor;
- 1.2.3. Një institucion të edukimit të lartë që mund të ndërtohet mbi një sipërfaqe territoriale prej 20,000 m² [2 ha];
- 1.2.4. Dy institucione shëndetësore që mund të ndërtohen mbi një sipërfaqe territoriale prej 20,000 m² [2 ha];
- 1.2.5. Tri qendra kulturore poli funksionale që mund të ndërtohen mbi një sipërfaqe territoriale prej 15,000 m² [1.5 ha] d.m.th 5,000 m² [0.5 ha] për një institucion kulturor;
- 1.2.6. Hapësirë për park dhe rekreim me sipërfaqe territoriale prej 112,186 m² [11.2186 ha];
- 1.2.7. Kopsht botanik me sipërfaqe territoriale prej 20,277 m² [2.0277 ha];

Rrugët edhe pse si bazë reference kanë pasur PRRU Prishtina e Re - Lindje (2013) dhe PZhU-në, për arsye të zgjidhjes urbane sa më efikase janë bërë disa zhvendosje optimale të tyre, brenda blloqeve, që në total përfshijnë rreth 5.06% të sipërfaqes së përgjithshme brenda kufirit të paraparë të këtij plani.

STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

DESTINIMI I SIPËRFAQEVE

Në bazë të kategorizimit të përgjithshëm, plani përfshinë sipërfaqe të planifikuara për ndërtim, sipërfaqe të planifikuara për ndërtim/afarizëm, sipërfaqe të planifikuara për infrastrukturë publike dhe sociale, sipërfaqe të lirë dhe sipërfaqe rrugore.



Harta XX. Destinimi i Sipërfaqeve

Struktura e planifikuar për banim

Janë planifikuar rreth 42 blloqe për realizimin e banimit me një sipërfaqe ndërtimore prej 899 756.558m².

Për parcelat në pronësi shtetërore-Republika e Kosovës, është planifikuar destinimi i blloqeve si në hartën e destinimit të sipërfaqeve, por nëse autoritetet shtetërore kërkojnë të kenë destinim tjetër, varësisht nga kërkesat, atëherë kjo mund të ju mundësohet por duhet respektuar kriteret për distanca, ISHPKZh, ISN dhe SNP.

Infrastruktura publike dhe Sociale

Sipërfaqet e tokës për çerdhe/kopsht janë të vendosura në pika kyçe ashtu që të jenë lehtë të qasshme dhe shpejt të arritshme në distance minimale të ecjes. Sipërfaqja totale e tokës për

çerdhe/kopsht është $15\,579.467\text{m}^2$, gjegjësisht rreth $3\,000\text{m}^2$ për pesë çerdhe/kopshte.

Kushtet për ndërtimin e çerdheve/ kopshteve janë: ISHPKZh max.40% dhe etazhiteti max P+1.

Janë planifikuar $31\,110.393\text{m}^2$ për tri shkolla fillore dhe $20\,004.668\text{m}^2$ për një shkollë të mesme.

Kushtet për ndërtimin e shkollave janë: ISHPKZh max.40% dhe etazhiteti max P+2.

Sipërfaqet e tokës për qendrat e mjekësisë familjare, janë të vendosura njëra në perëndim të lokacionit me një sipërfaqe prej $10\,233.664\text{m}^2$ dhe tjetra në veri të lokacionit me një sipërfaqe prej $10\,331.612\text{m}^2$.

Kushtet për ndërtimin e QMF janë: ISHPKZh max.40% dhe etazhiteti max P+1.

Hapësirat për rekreim sport, gjelbërim izolues janë të vendosura përgjatë gjithë zonës së planit me sipërfaqe të tokës prej $135\,506.171\text{m}^2$.

Kopshti botanik dhe hapësirat rekreuese përcjellëse janë vendosur në pjesën perëndimore të planit me sipërfaqe të tokës prej $73\,032.3915\text{m}^2$. Për këtë lloj të ndërtimit duhet të hartohet projekt i veçantë.

Kushtet për ndërtimin e kopshtit botanik: ISHPKZh max.40% dhe etazhiteti max P+1.

Qendrat kulturore janë të vendosura në disa pika karakteristike të lagjes me një sipërfaqe të tokës prej $15\,152.195\text{m}^2$, për tri qendër kulture. Njëra nga këto sipërfaqe është e destinuar për ndërtesë religjioze.

Kushtet për ndërtimin e qendrave kulturore: ISHPKZh max.40% dhe etazhiteti max P+2.

Po ashtu brenda zonës është planifikuar edhe një parking publike me sipërfaqe të tokës prej $2\,617.702\text{m}^2$.

Kushtet për ndërtimin e parkingut publik: ISHPKZh max.40% dhe etazhiteti max P+2.

Sipërfaqe rrugore e cila është planifikuar në këtë plan është rreth 13.4% të sipërfaqes së përgjithshme brenda kufirit të paraparë të këtij plani.




Figure 6. Riparcelimi i Propozuar

RREGULLAT URBANE DHE MËNYRAT E PËRTËRIRJES SË GJENDJES EKZISTUESE

BANIMI

Tipologjia tradicionale e blloqeve urbane është shndërruar në grupe të ndërtesave që krijojnë rrugë, duke mundësuar formësimin e oborreve të hapura. Hapësirat ndërmjet blloqeve shërbejnë si shtigje të gjelbëruara për ecje dhe rrugë për kycje. Oborret, gjenerojnë sensin e zotërimit të hapësirës.

Planifikimi i banimit, si funksion dominant i lagjes, është bërë duke u bazuar në analizën e numrit të banorëve dhe kërkesave të vazhdueshme për banim. Meqenëse zona e banimit kolektiv është zonë e re, gjatë planifikimit, lagja është ndarë në tërësi urbane.

Planifikimi i banimit bazohet në numrin e banorëve, rritjen e dendësisë së banimit dhe rritjen e etazhitetit, duke i ruajtur kushtet për jetë të shëndoshë - djellosje të mjaftueshme dhe hapësira të lira.

Lartësia e çdo ndërtese është e bazuar në lokacion, ekspozim të diellit, pamjes dhe proporcionit arkitektonike. Grupet me lartësi të njëjtë dhe me kulme të rrafshëta krijojnë koherencë brenda zonës.

Plani ka planifikuar këto lloje të ndërtesave të banimit;

1. Ndërtesat e banimit me një/dy njësi, në të cilën përfshihen;
 - Shtëpitë e veçanta, (së paku 4 ari)
 - Shtëpitë dyshe, (së paku 3 ari)
 - Shtëpitë në varg (së paku 2 ari)
2. Ndërtesat e banimit më shumë njësi dhe ndërtesat e banimit me shumë njësi me afarizëm
 - Ndërtesat e veçanta
 - Ndërtesat në varg
 - Ndërtesat terracore
 - Ndërtesat e banimit me shumë njësi me afarizëm

KONCEPTI I HAPËSIRAVE PËRRETH NDËRTESAVE

Të gjitha ndërtesat janë të integruara në rrjetin e gjelbër.

Hapësirat e gjelbëruara publike janë të plotësuara nga hapësirat e hapura gjysmë private, siç janë hapësirat ndërmjet ndërtesave si dhe hapësirat në mes të oborreve të blloqeve. Oborret e blloqeve janë komoditet i përbashkët për banorët e ndërtesave përreth. Mobiliari urban zgjeron komunikimin ndërmjet banorëve. Mbi të gjitha, hapësirat urbane janë të projektuara për njeriun, si për banorët ashtu edhe vizitorët.

Lugina e lumit/përroit është planifikuar të jetë si pjesë qendrore e planit dhe përgjatë të gjithë shtratis të tij është planifikuar gjelbërimi. shëtitore, rekreim për banorët dhe vizitorët.

Mbetet që me një projekt në të ardhmen të vazhdoj me organizimin e këtij shtrati të lumit së bashku hapësirat e tjera përcjellës për rekreim.

KUSHTET URBANE DHE SIPËRFAQET PUBLIKE, PRIVATE SI DHE ELEMENTE PËRCJELLËSE

Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar (ISN) është 0.82 për të gjitha parcelat që përfshihen në këtë plan. Sipërfaqja totale ndërtimore për të gjitha blloqet e banimit është 899 756.558 duke përfshirë sipërfaqet ndërtimore për infrastrukture publike dhe sociale. Për këto hapësira të parapara për ndërtimin e ndërtesave publike dhe sociale janë dhënë kriteret shtesë për secilin bllok.

Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh) varion nga 0.2-0.3 të ndërtesat e banimit me një/dy njësi (Shtëpitë e veçanta, dyshe dhe në varg) dhe 0.3 deri në 0.4 ndërtesat e banimit me shumë njësi (ndërtesat e veçanta, në varg dhe terracore).

Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP) max. 60%.

Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh) është i zgjidhur në nivel të planit, përmes përcaktimit të gabariteve të ndërtesave. Ndryshimi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale mund të behet deri në $\pm 2\%$ nga ai që është përcaktuar përmes gabariteve.

Gabaritet e ndërtesave janë përcaktuar vetëm në zonat në Pronësi Private, kurse në zonat në Pronësi Shoqërore dhe Komunale mbeten të përcaktohen me zgjidhje urbane varësisht nga prioritetet dhe interesat e institucioneve përkatëse në harmoni me kriteret e këtij plani. Përjashtimisht në blloqet ku parashihen ndërtesat me një/dy njësi (shtëpi të veçanta, shtëpitë dyshe dhe shtëpitë në varg), nuk janë përcaktuar gabaritet e ndërtesave dhe riparcelimi, kjo mbetet të definohet me zgjidhje urbane duke u bazuar në kriteret për parcelat minimale.

Në bllokun “I-5” të banimit individual ku parcela komunale është pjesë e këtij blloku gjatë riparcelimit mund të bëhet këmbimi i kësaj toke me tokë private.

Shpërndarje e përgjithshme e lartësive të ndërtesave përcaktohet nga topografia e lokacionit duke e shfrytëzuar pjerrtësinë e terrenit.

Blloqet	Emërtimi i bllokut	Sipërfaqja e bllokut brenda VRR.	Sipërfaqja totale e bllokut me ngarkesën e destinuar për shërbime publike	ISN	Sipërfaqja ndërtimore e bllokut
Banim me një/dy njësi	I-1	5001.107	8624.093952	0.82	7071.75704
	I-2	10698.289	18448.52539	0.82	15127.79082
	I-3	8120.004	14002.43534	0.82	11481.99698
	I-4	5369.046	9258.581577	0.82	7592.036893
	I-5	20157.376	34760.125	0.82	28503.3025
	I-6	2274.51	3922.249201	0.82	3216.244345
	I-7	8798.71	15172.82108	0.82	12441.71328
	I-8	11541.69	19902.91728	0.82	16320.39217

Banim me shumë njësi	M-1	12460.364	21487.11272	0.82	17619.43243
	M-2	36417.451	62799.59995	0.82	51495.67196
	M-3	79159.868	136506.2053	0.82	111935.0883
	M-4	19410.658	33472.45685	0.82	27447.41462
	M-5	36210.807	62443.25539	0.82	51203.46942
	M-6	33256.622	57348.94947	0.82	47026.13857
	M-7	8788.165	15154.63689	0.82	12426.80225
	M-8	13931.363	24023.75782	0.82	19699.48141
	M-9	9616.122	16582.39657	0.82	13597.56519
	M-10	7744.402	13354.73335	0.82	10950.88135
	M-11	8904.507	15355.26134	0.82	12591.3143
	M-12	35694.31	61552.58885	0.82	50473.12286
	M-13	13184.68	22736.15003	0.82	18643.64302
	M-14	14851.938	25611.23141	0.82	21001.20976
	M-15	5624.72	9699.475283	0.82	7953.569732
	M-16	9724.991	16770.13431	0.82	13751.51013
	M-17	26500.217	45697.9547	0.82	37472.32286
	M-18	23185.561	39982.03925	0.82	32785.27219
	M-19	23870.061	41162.41638	0.82	33753.18143
Banim me shumë njësi me afarizëm	MI-1	17279.049	29796.63142	0.82	24433.23776
	MI-2	14841.986	25594.06981	0.82	20987.13725
	MI-3	11707.588	20188.99793	0.82	16554.9783
	MI-4	18533.782	31960.33943	0.82	26207.47833
	MI-5	11957.81	20620.49	0.82	16908.8018
	MI-6	21900.451	37765.94802	0.82	30968.07738
	MI-7	8067.531	13911.94896	0.82	11407.79814
	MI-8	11623.567	20044.10901	0.82	16436.16939
	MI-9	4149.679	7155.860006	0.82	5867.805205
	MI-10	3739.702	6448.880498	0.82	5288.082008
	MI-11	3802.835	6557.749379	0.82	5377.354491
	MI-12	10366.894	17877.05559	0.82	14659.18558
	MI-13	2864.417	4939.506658	0.82	4050.39546
	MI-14	3778.378	6515.574823	0.82	5342.771355
	MI-15	1191.594	2054.828783	0.82	1684.959602
Total		636302.802	1097264.095		899756.5579

TABELA e llogaritjeve të blloqeve dhe sipërfaqet ndërtimore.

VIJAT RREGULLUESE TË RRUGËVE DHE SIPËRFAQEVE PUBLIKE SI DHE VIJAT E NDËRTIMIT

- Vija e rregullimit është e përcaktuar në raport me vijën e trasesë rrugore, sipas pjesës grafike.
- Vija ndërtimore është përcaktuar në raport me vijën e rregullimit. Distanca minimale dhe maksimale është 5 m deri në 10.0 m varësisht nga kategoria dhe profili rrugor.

PIKAT E LARTËSISË (KUOTAT) SE RRUGËVE DHE SIPËRFAQEVE PUBLIKE (PLANI I NIVELIT)

Gjatë planifikimit të rrjetit të trafikut është marrë parasysh topografia ekzistuese. Rugët janë të planifikuara komfor të gjitha standardeve për profilet gjatësore të rrugëve, në varësi të kategorisë së rrugës.




Figure 8. Plani i Nivelimit

ZGJIDHJA E RRJETIT TË INFRASTRUKTURËS: RRUGËT, FURNIZIMI ME UJË, UJËRAT E ZEZA, UJËRAT ATMOSFERIKE, TELEKOMUNIKIMET, ELEKTRICITETI, ETJ. SI DHE KYÇJET NË INFRASTRUKTURË

TRANSPORTI PUBLIK

Është propozuar që shërbimet ekzistuese të autobusëve lokal të zgjerohen në zonën e planit, me stacionet e autobusëve përgjatë rrugës kryesore. Kjo do të mundësojë që hapësirat e hapura, ato banimore dhe afariste të arrihen me autobus.



Figure 9. Infrastruktura Rrugore

INFRASTRUKTURA RRUGORE

Rrugët që e përkufizojnë këtë zonë janë ruajtur dhe ato janë të planifikuara në Planin Rregullues “Prishtina e Re-Lindje” dhe Planin Zhvillimor Urban, si Unaza e Brendshme, Unaza e Jashtme e Qytetit si dhe rrugët në pjesën lindore dhe perëndimore.

Gjithashtu planifikohen lidhjet (kyçjet) me rrjetin e trafikut të nivelit urban si dhe lidhjet me zonat urbane përreth, për të cilat janë hartuar planet apo janë në proces të hartimit.

Rrjeti i trafikut parasheh qasjen e automjeteve të emergjencës (zjarrfikëset, ndihma e parë) në vendbanimet brenda zonës së planit si dhe të parashikojë komunikimin e këmbësorëve dhe çiklistëve (sipas kushteve lokale).

Qasjet nëpër blloqe janë paraqitur në pjesën grafike si propozim i mundshëm dhe mund të ndryshojnë varësisht prej zgjidhjes urbane, por duhet të sigurohet që këto qasje të jenë nga rrugët e brendshme të planit.

KATEGORITË E RRUGËVE

Me këtë plan janë planifikuar këto kategori të rrugëve:

- rruga e planifikuar Tipi A -16m
- rruga e planifikuar Tipi A -18m

Këto rrugë janë të planifikuara për qarkullim të rrjedhshëm, lidhin pjesët e veçanta brenda kufirit të planit si dhe mundësojnë lidhshmëri me pjesët tjera të qytetit. Në këto rrugë janë të planifikuara shtigje për këmbësorë dhe çiklistë, si dhe drunjtë përreth etj.




Figure 10. Profili i Rrugëve

RRUGËT PËRMBLEDHËSE

Këto rrugë lidhin pjesë të ndryshme të planit si dhe mundësojnë distribuimin e trafikut nga rrugët kryesore si dhe drejtë tyre. Në parim janë të planifikuara si rrugë me dy korsi (secili drejtim nga një korsi me gjerësi min. 3m), me shtigje për këmbësorë-trotuare, me drunjë anash, breze të gjelbërta si dhe shtigje për çiklistë.

RRUGËT TJERA

Rrugët tjera janë rrugë brenda blloqeve përmes të cilave i qasemi pjesëve të tjera si dhe përmbajtjeve të planifikuara me këtë plan.

Profilet e të gjitha rrugëve janë të paraqitura në pjesën grafike në – Rrjetin e rrugëve. Korridoret e planifikuara mund të ndryshohen nëse gjatë hartimit të projektit kryesor të rrugëve paraqitet nevoja e përshtatjes së korridoreve me kushtet teknike. Struktura themelore dhe funksionale e rrugëve brenda kufirit të planit nuk guxon të ndryshohet.

Kalkulimi i frekuencës së lëvizjes së makinave dhe shpërndarja tregon se planifikimi i rrjetit rrugor është i mjaftueshëm për të akomoduar trafikun e gjeneruar të automjeteve. Rrugët lokale brenda lokacionit variojnë nga 16m deri në 18m gjerësi. Zonat anash janë të planifikuara për ecjen e këmbësorëve dhe çiklisteve.

Disa rrugë sekondare japin qasje nga rruga kryesore dhe në vendparkim. Ato janë të planifikuara si hapësira me destinim të përbashkët mes këmbësorëve, çiklistëve dhe automjeteve.

ECJA DHE ÇIKLIZMI

Rrjet i përbashkët i trotuareve për këmbësorë dhe shtigjeve për çiklistë, është propozuar në të gjithë lokacionin e planit.

Parkingu i sigurt për çiklistë duhet të sigurohet në qendër të lokacionit por edhe përbrenda zonave të banimit dhe ato afariste.

PLANI I PARCELIMIT DHE I RIPARCELIMIT TË PROPOZUAR

Procesi i zhvillimit të suksesshëm të zonës është ngushtë i ndërlidhur me komponentin e rregullimit të pronës me anë të procesit të riparcelimit të propozuar.

Plani i parcelimit dhe i riparcelimit ashtu siç është paraqitur në hartë, mund të pësojë ndryshime varësisht prej marrëveshjeve të pronarëve të parcelave, duke mos tejkaluar sipërfaqet e bllokut të paraparë më tepër se $\pm 2\%$. Nuk mund të bëhet bartja e të drejtës ndërtimore nga një bllok në tjetrin për parcelat në të cilat është planifikuar ndërtimi i banimit. Për ato parcela e drejta ndërtimore realizohet brenda bllokut ku gjenden.

Shpronësimi i tokës ku janë paraparë hapësirat për infrastrukturë publike, sociale apo teknike realizohet me marrëveshje, tërësisht apo proporcionalisht me realizimin e ndërtesave të blloqeve, sipas sipërfaqes së përcaktuar në pjesën grafike për blloqet përkatëse.

Nga sipërfaqja e tërësishme e planit janë planifikuar 42.1% për infrastrukturë publike, sociale, rrugore apo teknike. Kjo sipërfaqe shpronësohet me koeficient të ndërtimit sipas shpërndarjes së saj në kuadër të blloqeve të ndërtimit për banim të paraparë në pjesë të planit, sipas procedurave të shpronësimit me marrëveshje.

Pasi pronat për infrastrukturë publike, sociale apo teknike të kalojnë në pronësi Komunale, Komuna vendosë për ndërtimin e infrastrukturës publike, sociale, rrugore dhe teknike ashtu siç janë paraparë me plan sipas prioriteteve.

Sipërfaqet ndërtimore që i takojnë Komunës së Prishtinës për banim dhe afarizëm, sipas kushteve të parapara me Planin Rregullues të Hollësishëm, mund të realizohen me vendime nga Komuna e Prishtinës, në përputhje me ligjet në fuqi.

Në blloqet ku parashihen ndërtesat me një/dy njësi (shtëpi të veçanta, shtëpitë dyshe dhe shtëpitë në varg), nuk janë përcaktuar gabaritet e ndërtesave dhe riparcelimi, kjo mbetet të definohet me zgjidhje urbane duke u bazuar në kriteret për parcelat minimale.

Sipërfaqet e përcaktuara për shpronësim (shih tabelën) të blloqet e destinuara me ndërtesat me një /dy njësi (shtëpi të veçanta, shtëpitë dyshe dhe shtëpitë në varg), mund të ngarkohen proporcionalisht (sipas madhësisë së bllokut) në blloqet e destinuara për banim me shumë njësi dhe ndërtesat e banimit me shumë njësi me afarizëm.

Në bllokun “1-5” të banimit individual ku parcela komunale është pjesë e këtij blloku gjatë riparcelimit mund të bëhet këmbimi i kësaj toke me tokë privatë.

PLANI I ZBATIMIT

Implementimi i planit do të bëhet në faza me marrëveshje të pronarëve të tokave dhe investorëve në harmoni me kriteret e këtij plani.

BASHKËPRONËSIA

Përgjegjësitë e Komunës ndaj ndërtesave në bashkëpronësi duhet të jenë konform Ligjit për ndërtesat në bashkëpronësi Nr.04/L-134.

Te parcelat kadastrale të bashkuara për ndërtim të ndërtesës banimore/afariste me shumënjësi, sipërfaqja jashtë ndërtesës do të trajtohet pas përfundimit të ndërtesës si hapësirë publike duke u bazuar në Nr.04/L-134, kurse pjesa e parcelës nën ndërtesë do të trajtohet si bashkëpronësi e tërë pronarëve të ndërtesës.

NORMAT DHE STANDARDET TEKNIKE PËR ZHVILLIMIN URBAN DUKE PËRFSHIRË SHKALLËN E PLANEVE

Gjatë planifikimit të zhvillimit urban brenda zonës së planit, sa i përket parametrave për destinimin e sipërfaqeve, dendësisë ndërtimore, rrjetit të përgjithshëm të trafikut si dhe infrastrukturës komunale janë përdorur normat e teknike të planifikimit hapësinor.

Me këtë plan është definuar që, për hartimin e projekteve për rrugët e veçanta si dhe për hartimin e projekteve për infrastrukture komunale dhe urbane, të respektohen normat dhe standardet teknike lokale.

KUSHTET DHE KRITERET PËR MBROJTJEN MJEDISORE

Masat për ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit do të zbatohen në harmoni me ligjet në fuqi si dhe me vendimet dhe udhëzimet që janë relevante me këtë problematikë.

Brenda zonës së planit nuk lejohet ndërtimi i ndërtesave që potencialisht do të rrezikojnë jetën dhe punën e qytetarëve, përkatësisht që do të rrezikojnë vlerat e përcaktuara sipas rregulloreve të posaçme për mbrojtjen e mjedisit.

Strategjia e përgjithshme për zhvillimin e peisazhit të zonës do të jetë e bazuar në një princip - dendësi sa më të madhe të trungjeve (sa më shumë që është e mundur), në mënyrë që lagjja të bëhet e përshtatshme si një mjedis natyror i jetesës, një mjedis i gjallë që ka karakter urban në krahasim me vendin ku është vendosur. Si lagje e gjelbër, ndjesia e të qëndruarit aty është sikur të jesh në një zonë të pyllëzuar të qytetit.

KUSHTET DHE KRITERET PËR SHFRYTËZIMIN RACIONAL TË ENERGJISË

Orientimi i ndërtesave është projektuar në atë mënyrë që të ketë ekspozim diellore në nivel maksimal, për të mundësuar ndriçim natyror gjatë ditës në fasadat e ndërtesave si dhe për mundësinë e ngrohjes gjatë dimrit.

Kolektorët solar si dhe burimet tjera që shërbejnë për nevojat energjetike mund të vendosen në ndërtesa dhe parcela, në zonat e të gjitha destinimeve me kusht që të mos shkatërrohen kushtet lokale si dhe të mos pengojnë në funksionimin e destinimit përkatës.

KUSHTET NË LIDHJE ME MBROJTJEN MJEDISORE NGA LLOJE TË NDRYSHME TË NDOTJES, MBROJTJA E BIODIVERSITETIT, MBROJTJA NGA ZJARRI DHE FATKEQËSITË E TJERA SI DHE SHKATËRRIMET

Me këtë plan përcaktohen masat që duhet të arrihen për qëllim të mbrojtjes dhe përmirësimit të gjendjes së mjedisit.

- zbatimi i masave për ruajtjen e ajrit,
- zbatimi i masave për ruajtjen e tokës,
- zbatimi i masave për ruajtjen e ujit.
- zbatimi i masave për mbrojtjen nga zhurma

RUAJTJA E AJRIT

Për të arritur nivelin sa më të pastër të ajrit gjithsesi duhet të kemi kontrollin permanent të kualitetit të ajrit në zonat e banimit. Brenda kufirit të planit nuk mund të kemi destinime të cilat e ndotin mjedisin dhe e vështirësojnë funksionimin e lagjes.

RUAJTJA E TOKËS

Duke shfrytëzuar në mënyrë racionale hapësirën për ndërtim, një pjesë e tokës do të ruhet në pjesën e parkut qendror si dhe oborret gjysmë të mbyllura në kuadër të ndërtesave të banimit duke ruajtur kualitetin e hapësirës në përgjithësi.

RUAJTJA E UJIT

Për ruajtjen e ujit është me rëndësi ndërtimi i rrjetit të planifikuar për kanalizimin e ujërave të zeza. Ujërat e zeza duhet të derdhen në rrjetin e kanalizimit publik i cili ka impiantet për pastrimin e ujërave të zeza.

MBROJTJA NGA ZHURMA

Masat e mbrojtjes nga zhurma bëhen duke aplikuar rregulloret në fuqi. Në veçanti kur kemi të bëjmë me ndërtimin e ndërtesave të posaçme që me prezencën e tyre mund të jenë burim i zhurmës së tepruar atëherë duhet aplikuar rregulloret sikur distanca minimale e këtyre përmbajtjeve nga ndërtesat tjera. Masat e rëndësishme për mbrojtje nga zhurma e tepruar janë: matja e rregullt e nivelit të zhurmës, kufizimi apo ndalimi i punës në ndërtesat që janë burim i zhurmës etj.

MBROJTJA NGA ZJARRI DHE FATKEQËSITË E TJERA

Për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri, gjatë procesit të lëshimit të lejes ndërtimore, duhet aplikuar rregullativ ligjor në fuqi.

Në tërë zonën e planit duhet ndërtuar rrjetin e hidrantëve sipas rregulloreve profesionale. Duhet të sigurohen sasi të mjaftueshme të ujit për fikjen e zjarrit, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Për ndërtesat e banimit kolektiv, ndërtesat publike dhe afariste apo për ndërtesat komplekse (përveç shtëpive individuale) duhet punuar elaboratin e mbrojtjes nga zjarri sipas normave dhe

rregulloreve ligjore. Ky elaborat është pjesë përbërëse e projektit kryesor që punohet gjatë procesit të lëshimit të lejes ndërtimore.

POZITA E NDËRTESES NË PARCELË DHE NË KUADER TË PARCELAVE FQINJE DHE DISTANCA MË E VOGËL NDËRMJET NDËRTESAVE

- Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh) varion nga 0.2-0.3 të ndërtesat e banimit me një/dy njësi (Shtëpitë e vecanta, dyshe dhe në varg) dhe 0.3 deri në 0.4 ndërtesat e banimit me shumë njësi (ndërtesat e veçanta, në varg dhe terracore);
 - Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP) max. 60%;
 - Distanca më e vogël në mes të ndërtesave është 1H -1.5H prej ndërtesës më të lartë;
 - Distanca nga fqiu (kufiri i parcelës) ku ka hapje primare është 0.5H - 0.75H, kurse ku ka hapje të kthinave sekondare (si psh. tualete, depo, shkallë etj.) është 0.25H. me marrëveshje me fqin ndërtësat mund të ngjiten;
 - Kuota e përdhese së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se sa kuota e niveletës së rrugës publike;
 - Kuota e përdhese mund të jetë më së shumti 1.2 m mbi kuotën zero;
 - Terasat dhe ballkonet lejohen sipas normave teknike të planifikimit hapësinor;
- Në raste kur nuk mund të zbatohen këto rregulla, kur terreni është i pjerrët atëherë:

- Çdo gabarit i cili del deri në 1.2 m mbi kuotën zero llogaritet suterren;
- Suterren – kati i cili gjendet nën përdhese, ku së paku 50%, e vëllimit të tij është mbi nivelin e tokës apo njëra ballore e tij është mbi nivelin e tokës;
- Bodrum – kati i cili gjendet nën përdhese, apo suterren ku më shumë se 50%, e vëllimit të tij është i futur nën nivelin e tokës;

Kushtet për lëvizje pa pengesa të personave me nevoja të veçanta:

- Ndryshimet më të mëdha se 13cm të nivelit të sipërfaqes ku qarkullohet, duhet të punohen si rampa;
- Rampat për persona me nevoja të veçanta nuk lejohet të kenë pjerrtësi më të madhe se 6%, për gjatësi deri 600cm;
- Për gjatësi më të madhe duhet të punohen pushimore min 200cm;
- Dyshemeja e rampave duhet të jetë e fortë, rezistente ndaj rrëshqitjes;
- Duhet të sigurohet 1 vendparking për persona me nevoja të veçanta për çdo 30 vendparkingje;
- Për çdo 30m² afarizëm të sigurohet një vend parkim.

- Parkingu për persona me nevoja të veçanta duhet të jetë min. 350 cm i gjerë, ose të punohet në kombinim me hapësirën për manipulim 230+120 cm;
- Madhësia min. e ashensorit duhet të jetë 110 x 140 cm, por preferohet të mos dimensionohet për më pak se 8 persona;
- Parcelat e banimit kolektiv nuk duhet të rrethohen;
- Shkallët në hyrje të ndërtesave të cilat kanë lartësinë mbi 1.2m, nuk lejohet të vendosen mes vijës rregulluese dhe ndërtimore;
- Rampat– duhet të planifikohen në atë mënyrë që të mos pengojnë lëvizjen e këmbësorëve.

Lartësia më e madhe e strukturave si oxhaqet e ventilimit dhe hapësirat e ashensorëve, mund të lejohen vetëm nëse janë të larguara nga perimetri i ndërtesës për më së paku sa lartësia e vet strukturës.

Këto specifikacione duhet të jenë në harmoni me ligjet në fuqi.

LARTËSIA E NDËRTESAVE

Lartësia e ndërtesave definohet nga zgjidhja urbane e planifikuar.

Lartësia dysHEME-dysHEME është 3m për banim dhe 4,5m për afarizëm. Thellësitë e ndërtesave zakonisht nuk tejkalojnë 16m.

Këto specifikacione duhet të jenë sipas ligjeve në fuqi.

KUSHTET PËR NDËRTIMIN E NDËRTESAVE TË TJERA NË PARCELËN E NJEJTË NDËRTIMORE

Në parcelën ndërtimore janë përcaktuar gabaritet e ndërtesave dhe nuk lejohet që të kenë objekte ndihmëse shtesë.

KUSHTET DHE MËNYRAT E SIGURIMIT TË HYRJES NË PARCELË DHE NË HAPËSIRËN E PARKIMIT

PARKIMI DHE GARAZHIMI

Standardi i parkimit është një vendparkim/një banesë. Në hapësirat e parkimit publik duhet të parashihen parkingjet për personat me nevoja të veçanta. Parkimi është planifikuar në përgjithësi me garazhe nëntokësore, të cilat do të mundësojnë më shumë hapësirë të hapur për këmbësorë dhe çiklistë. Kjo është një qasje e qëndrueshme që jo vetëm siguron ajër të pastër, por dhe një mjedis të sigurt për këmbësorë dhe çiklistë.

Për çdo 30m² afarizëm duhet të sigurohet një vend parkim.

Parkingjet e banorëve ndodhen nën ndërtesa për çdo parcelë ndërtimore, të cilat arrihen përmes rampave. Garazhimi nëntokësor mund të vendoset në tërë sipërfaqen brenda vijës ndërtimore të parcelës dhe etazhiteti nuk është i kufizuar, por me kusht që të gjitha etazhet të jenë nëntokë dhe mbi këtë sipërfaqe (plato) të organizohet gjelbërim, hapësira për sport dhe rekreim dhe mobiluar urban i nevojshëm. Realizimi i garazhimit nëntokësor duhet të bëhet në faza dhe pas përfundimit të çdo faze, pjesa e nëntokës duhet të funksionoj si një tërësi.

DEPONIMI I MBETURINAVE

Nëpër blloqe duhet përcaktuar pikat për deponimin e mbeturinave në kontejnerë. Këto hapësira përveç që duhet pasur qasje të lehtë nga rruga, ato gjithashtu duhet të jenë vizuelisht të izoluar, mos të pengojnë lëvizjen e lirë të këmbësorëve dhe veturave.

KUSHTET PËR DEFINIMIN E RRETHOJAVE

Parcelat ndërtimore të banimit kolektiv nuk duhet të rrethohen, mund të rrethohen vetëm ndërtesat e çerdheve-kopshtet dhe shkollat.

FORMËSIMI ARKITEKTONIK DHE ESTETIK I ELEMENTEVE TË ÇAKTUARA TË NDËRTESES

Materialet propozohen të jenë me suvatim, e cila është më tipike për fasadat e ndërtesave lokale, si dhe guri natyror, tulla dhe fibra të çimentos. Me përjashtim, mund të përdoren dru dhe beton i ekspozuar.

Dritaret duhet të jenë me xhama të dyfishtë ose trefishtë për shkak të efijencës së energjisë dhe konforin e banorëve. Varësisht nga lloji i fasadës, parmakët e ballkoneve duhet të jenë solide ose me xham.

Ngjyrat natyrale duhet të përdoren për pjesët kryesore të fasadës, ngjyrat e theksuara të përdoren kryesisht në lozhe dhe ballkone, në disa raste për të gjithë fasadën.

Kulmet e rrafshëta janë aplikuar për të gjitha ndërtesat. Ato nuk mbulojnë horizontin e përgjithshëm, shmangin rrëshqitjen e dëborës në rrugë dhe trotuare dhe mund të shfrytëzohen për çati ose terrasa private. Kulmet e definuar si jo të qasshme mund të plotësohen me kulme të gjelbëra. Kulmet e gjelbëra nuk e rrisin peshën, forcojnë izolimin, kontribuojnë për të reduktuar reflektimin urban dhe rrisin mbrojtjen e mos depërtimit të shirave të dendur.

JO KONFORMITET, PËRJASHTIMET

Plani nuk parasheh jo konformitete e as përjashtime pasi që zona e trajtuar me plan është plotësisht zonë e pa ndërtuar.

KUSHTET PËR RENOVIM DHE RIKONSTRUIM TË NDËRTESAVE EKZISTUESE

Plani nuk parasheh kushte për renovim dhe rikonstruim të ndërtesave ekzistuese pasi që zona e trajtuar me plan është plotësisht zonë e pa ndërtuar.

KUSHTET PËR VENDOSJEN E NDËRTESAVE TREGTARE, DEPOVE APO FABRIKAVE

Në këtë zonë janë planifikuar ndërtesa me banim dhe afarizëm përgjatë rrugëve kryesore që përshkon plani dhe nuk janë të planifikuara destinime ekonomike.

KUSHTET PËR NDËRTIMIN E NDËRTESAVE ME RËNDËSI STRATEGJIKE

Preferohet që për të gjitha ndërtesat publike të organizohen konkurse urb-arkitektonike, ashtu që me përzgjedhjen kualitative hapësinore do të ndikonin në arritjen e qëllimeve strategjike për zonën përreth.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

VSM nuk është hartuar për këtë planë sepse ndodhet në kuadër të PZhK së Prishtinës dhe kur është hartuar ky plan ka përmbajtur edhe këtë pjesë.

INSTALIMET ELEKTRIKE

RRJETI ELEKTROENERGJETIK DHE RRJETI TELEKOMINIKUES

Rregulloret që u është referuar projekti

Ky projekt ka për qëllim që në bazë të parashikimeve të prezentuara për numrin e banorëve dhe rritjen ekonomike të lagjes të projektojë ndërtimin e rrjetit të ri elektroenergjetik.

Projekti është perpiluar duke ju përmbajtur rekomandimeve të IEC-së për hartimin e planeve të sistemeve elektroenergjetike. Me poshtë janë të rënditura këto rekomandime;

Linjat furnizuese të trafo stacioneve 10/0.4Kv/Kv, janë paraparë të gjitha me kablllo nëntokësore, i gjithë kompleksi planifikohet të furnizohet me energji elektrike nga trafo stacioni PRISHTINA 7 dhe propozohet të realizohet në tri unaza energjitike me kablllo XHP 49A 3x(1x240mm²) të tensionit 20kV.

Në situacion janë dhënë lokacionet e trafo stacioneve 10/04kV të vendosura në trafo blinda apo edhe bodrume të banesave kolektive. Fuqia e tyre është e mjaftushme për furnizimin me energji elektrike planin.

1. Mbledhja e shënimeve për rrjetin ekzistues
2. Analiza e të dhenave të mbledhura
3. Analiza e ngarkesave aktuale dhe atyre të parashikuara
4. Planifikimi i lokacionit të TS-ve 10(20)/0.4kV dhe zonave që mbulojnë ato.

Për planifikim të zgjerimit të mëtutjeshëm të SEE apo përmirsim të atij ekzistues janë marrë parasysh dy rekomandimet e mëposhtme:

1) Rekomandimet e master planit për zhvillimin e sistemeve shpërndarëse të Kosovës deri në vitin 2015 që obligojnë që:

- ☐ Eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV
- ☐ Kalimin nga rrjeti distributiv 10kV në rrjetin distributiv 20kV
- ☐ Zëvendësimin e TS 10/0.4kV me ata 20/0.4kV

☑ Zëvendësimin i Linjave Ajrore 230/400V me kablllo ajrore apo nëntokësore.

2) Rekomandimet e IEC-s për projekte të reja në vendet urbane të cilat obligojnë që:

☑ Kabllat për furnizim me energji elektrike dhe kabllat e telekomunikimit duhet të vendosen në të njëjtën trase dhe në të njëjtën kohë.

☑ Sistemet El.En duhet të plotësojnë së paku kushtin “N-1” që do të thotë se duhet të kemi furnizim të rregullt me energji edhe në rast se bjen nga puna një vijë furnizuese.

1. Përshkrimi i propozimeve të projektit

Synim i këtij plani është furnizimi me energji elektrike i kësaj pjesë. Paraprakisht për këtë furnizim janë nevojitur të dhënat për numër të banorve, të dhënat për destinimin e hapsirave dhe objektet që parashihet të ndërtohen dhe lloin e atyre objekteve. Këto të dhëna janë marrë nga grupi i eksptëve të planifikimit urban që janë duke kryer këtë plan.

Për llogaritje të energjisë elektrike të nevojshme në amvisni jemi bazuar në numrin e banorve që parashihet të vendoset në këtë pjesë, ndërsa për objektet tjera jobanuese (administratë, shëndetsi, arsim, afarizëm apo industri e lehtë) është marrë një mesatare e shpenzimit të energjisë elektrike në njësi të sipërfaqes së objekteve ($\text{ë}/\text{m}^2$). Më detalisht forma e llogaritjes është dhënë në kapitullin në vazhdim (pika 3) e këtij punimi.

Trasa e kabllave të të gjitha llojeve është vendosur përgjatë rrugëve të planifikuara nga planifikuesit e transportit rrugorë. Pozicioni i saj është dhënë në një vizatim të veçant ku janë dhënë prerjet tërthore të rrugëve. Aty shifet kanali i kabllave me kablla të vendosur në gypa dhe gypa rezervë për instalime të mëvonshme. Në projektet detale që do të punohen veq e veq për zona të caktuara duhet të parashihen edhe pusetat dhe kabllat gjegjëse që duhet të vendosen në kanale. Në këtë hapsirë të gjitha instalimet elektrike duhet të jenë nëntoksore të vendosura nëpër kanale gjegjëse.

Nëpër vizatime dhe në pjesë tjera të këtij plani është cekur se trafot duhet me qenë të parapara për punë edhe në tensionin 10kV edhe në ate 20kV, ndërsa të gjitha kabllat duhet me qenë të tipit XHE-24kV.

Janë edhe dy linja 35 kV që kalojnë nëpër hapsirën e projektit tonë. Meqense në të ardhmen këto linja pritet që të eliminohen ose të kalojnë në sistemin 20kV nuk janë marrë në shqyrtim në pjesën e planifikuar. Pra nëse ato nuk eliminohen por shëndrrohen në linja 20kV ato do të futen në sistemin kabllorë nëntoksorë njësoj si linjat 20kV të shpjeguara më lartë.

Janë gjithashtu edhe dy linja 110kV të cilat, mbrenda afatit që përfshinë ky plan, nuk parashihen të vendosen ose të futen në sistem kabllorë nëntoksorë. Për këtë arsye ekipi i planifikuesve ka parapa një zonë të gjelbër me gjërsi 40m duke pasur aksin e këtyre linjave në qendër të zonës.

Në aspektin planit hapsinorë duhet pasur kujdes që të gjitha trafostacionet është parapa me qenë të ndërtuara në shtëpiza të betonit ose shëpiza të llamarinës. Për këtë arsye në vendet ku është parapa vendosja e tyre duhet të rezervohet një hapsirë minimale prej rreth 45m². Nëse trafostacioni nuk ndodhet në afërsi të rrugës, duhet të sigurohet një rrugë me gjerësi minimale 3.5m nga rruga deri te vendvendosja e TS-ve.

Meqense sipas standardeve të IEC-s sistemet elektroenergjetike së paku duhet ta plotsojnë kushtin "N-1" me këtë projekt është parapa që të gjitha TS-t të lidhen në disa unaza.

Unaza ka për qëllim që në rastë se bjen nga puna një linjë apo një TS furnizimi i pjesës së rrjetit pas pjesës në defekt të bëhet nga ana tjetër.

Nga aspekti i furnizimit me energji elektrike kjo lagje ndodhet në mes dy trafostacioneve të forta; Prishtinës II dhe Prishtinës 7. Prishtina II ka tre transformatorë 35/10kV me fuqi nga 8MVA secili dhe Prishtina 7 ka dy transformatorë 110/10(20)kV me nga 63MVA.

Nëpër lagjen që jemi duke e planifikuar kalojnë dy linja 110kV. Në të ardhmen këto dy linja të kalojnë në linja kabllore nëntoksore. Në këtë projekt nuk është parapa trasa e tyre sepse ato nderlidhen edhe me zona tjera të qytetit. Si të tilla janë pjesë e projekteve zhvillimore urbane të Prishtinës. Përkohësisht është parapa një zonë siguroese përgjat aksit të tyre me gjërsi rreth 40m për secilën.

Në bazë të ngarkesës dhe shpërndarjes gjeografike të trafostacioneve janë parapa gjithsejt 6 unaza. Unazat 1 deri në 5 janë të furnizuara nga dy drejtime, pra nga TS PRII-35/10kV dhe nga TS PR7-110/10(20)kV. Unaza 6 për shkak të shtrirjes së saj gjeografike furnizohet me dy kablla XHE vetëm nga TS PRII-35/10kV.

Për të arritur që furnizimi i tërë unazave të shkoj pa problem edhe gjatë havarive në ndonjërin prej TS-ve ose linjave të gjitha kabllat janë parapa të jenë të tipit XHP-A 1x240mm².

Kjo kabell në kushte dimrore, kur edhe nevojat për energji elektrike rriten, mund të ngarkohet deri në 360A që në sistemin 20kV është 16 MVA ndërsa në atë 10kV është 8 MVA. Kjo do të thotë se lagja “Pr-e re,z.P Lindore” me këtë kabell dhe me zgjedhjet e propozuara për TS dhe unazë praktikisht e siguron një furnizim të rregullt me energji elektrike sa i përket sigurisë së rrjetit. Për shkak të ngarkesës së madhe të unazës 3 për këtë qark janë parapa dy kablla paralele të të njëjtit tip.

Më poshtë është dhënë lista e trafostacioneve me të dhënat e nevojshme për fuqi dhe kablla furnizuese të propozuara.

2. Kerkesat për Energji Elektrike

Meqense në Kosovë për fat të keq nuk ka ndonjë studim zyrtarë të parametrave të shpenzimit të energjisë elektrike (fuqia mesatare e instaluar, fuqia e njëkohshme, shpicet e enregjisë elektrike të familjes mesatare, etj...) për llogaritje të tyre në amvisni në do të nisemi nga një familje mesatare kosovare me 6 antarë të familjes.

Në bazë të shënimeve që unë kam mbërri me i përcjellur, shpenzimet mesatare mujore të familjes 6 antareshe me standard mesatar sillen nga (900 deri 1200)këh. Këto familje nuk e shfrytzojnë energjinë elektrike për nxemje ose për klimë.

Meqense nuk kemi mundur të përcjellim shumë familje të tilla (pra janë rreth 20 familje) dhe me qëllim që gabimet të kanë shenjë positive, në për llogaritje do të përvetsojmë vlerat maksimale. Nga kjo do të nxjerrim shpenzimet mesatare ditore të en. elektrike për familje mesatare 6 antarëshe Kosovare.

Pra : Emm=1200këh Emm - Energjia mesatare mujore

$$Emd = Emm/30 = 1200kwh/30 = 40kwh/ditë$$

Emd - Energjia mesatare ditore

Energjia mesatare ditore nuk do të shfrytëzohet njëtrajtësisht brenda 24 oreve. Shpenzimet janë të përqendruara nga ora 8 e mëngjezit deri në orën 22, pra 14 orë. Megjithatë edhe mbrenda kësaj kohe vlera e shpenzimit ndrron përafërsisht në raport 3:1. Për të përafëruar llogaritjet tona në do të themi se mbrenda 12 oreve do të kemi shpenzim përafërsisht të njëtrajtshëm që do të thotë që shpenzimi prej 40kWh bëhet mbrenda 12 oreve përafërsisht barabar në secilën orë. Nga këto të dhëna shumë të përafëruara do të llogarisim fuqinë e njëkohshme për një familje të cilën e kemi marrë si shembull të familjes mesatare

$$P_{nj} = \frac{E_{md}}{30tm} = \frac{40kwh}{12h} = 3.33kW$$

P_{nj} - Fuqia e njëkohshme e shpenzuar për një familje 6 antareshe

Meqenëse familja që po e shqyrtojmë i ka 6 banorë, atëherë fuqia e njëkohshme për kokë të banorit është:

$$P_{nj} = E_{nj}/n = 3.33kW/6 = 0.56kW/banorë$$

P_b - Fuqia e njëkohshme e shpenzuar për banorë

Për të përafëruar llogaritjet për nevojat për energji elektrike të familjes Kosovare është e nevojshme të dihet koeficienti i njëkohshmerisë së shfrytëzimit të paisjeve elektrike. Ky koeficient në vendet e regjionit sillet nga 0,15 deri në 0,2. Për këtë llogaritje nevojitet lista e paisjeve elektrike me fuqitë përkatëse. Më

Nr.	Emri i paisjes elektrike	Fuqia e inst. (kë)
1	Shporeti elektrik	7.5
2	Bojleri i banjos	2.0
3	Bojleri i kuzhines	2.0
4	Rrobalsja	2.5
5	Enalarsja	2.5

6	Hekuri për hekurosje	1.0
7	Fshisa	0.8
8	Frigoriferi	0.5
9	Frizi	0.3
10	Paisjet elektronike (TV, PC, Radio etj...)	0.5
11	Ndriqimi	0.6
Gjithsejt		20 kë

Pra fuqia e instaluar e paisjeve elektrike të një familje mesatare është $P_{ins} = 20\text{kë}$

Nga kjo del se koeficienti i njëkohshmerisë është:

$$\mu = P_{nj}/P_{inst} = 3.33\text{kë}/20\text{kë} = 0.1665$$

Duke u bazuar në këtë koeficient shofim se përkunder numrit të vogël të familjeve tek të cilat janë përcjellur shpenzimet e energjisë elektrike rezultatet janë brenda kufijve ku sillet edhe regjioni andaj edhe mund ti shfrytzojmë si përafërsisht të sakta për llogaritjet e ardhshme.

Plani rregullativ i lagjes përpos objekteve të banimit ka edhe objekte tjera: Arsimore, tregtare, administrative, etj..., Për llogaritje të nevojave për energji elektrike të këtyre objekteve do të shfrytzojmë tabela të gatshme më të dhëna të rekomanduara nga studime që bazohen në sipërfaqet e shfrytzueshme të këtyre objekteve.

Më poshtë po dhëmë tabelën e lartë përmendur e cila do të na nevojitet për llogaritje të energjisë elektrike në të gjitha objektet që nuk janë të dedikuara për banim.

Nr	Lloji i objektit	Fuqia njësi e rekomanduar ë/m ²	Fuqia njësi e përvetsuar ë/m ²
1	Objektet arsimore	10 – 25	20
2	Objektet shëndetsore me nxemje	40 – 60	60
3	Qendrat sportive	10 – 50	30
4	Hotelet pa klimë	20 – 30	30
5	Hotelet me klimë	30 – 70	50
6	Objektet tregtare	25 – 60	25
7	Administrata	15 – 30	30
8	Prodhim (zeje, puntori)	50-100	60

Meqense nga ekspertët e urbanistikës nuk është caktuar lloji i objekteve për këtë planë është përvetsuar koeficienti mesatar për të gjitha llojet e objekteve $k=35\text{ë/m}^2$ që është i përafërte, por i mjaftueshëm për planifikim.

3. Llogaritjet për nevoja të energjisë elektrike

Bazë për llogaritje është marrë ndarja në destinime të ndryshme

Përshkrimi i sipërfaqeve dhe nr.banoreve në objekte banimi	Sipërfaqet dhe nr i banorëve	Nr i kë per koke banori,dhe sipërfaqe	Fuqia e nevojshme me banore	NR i Trafostacioneve
Nr i banoreve në objektet e banimit	31,000	0.56000	17360	20x1000 KVA
Totali i hapsirave komunale m2	517,368	0.0350	18107.88	20x1000 KVA
Banim i përzier me afarizëm m2	78,063	0.0350	2732.202291	3x1000K VA

4. Planifikimi i ndriçimit të rrugëve

Në projektet e rrugëve duhet të projektohet edhe ndriçimi i rrugëve. Në këtë planë janë dhënë vetëm përcaktimet parimore në bazë të të cilave duhet të punohet projekti i ndriçimit të secilës rrugëve. Në një vizatim të veçant janë dhënë prerjet e secilit lloj të rrugës. Në atë prerje janë dhënë pozita e llampës ndaj rrugës, lloji i llampës, numri i llampave në një shtyllë, lartësia e llampës, forma e vendosjes së llampave dhe distance ndërmjet dy llampave të një krahu. Të gjithë këta parametra janë të përafërt. Vetëm pas llogaritjeve të sakta në projekte detale do të dihen saktësisht këta parametra.

Llogaritjet e këtyre parametrave duhet të bazohen në varshmëri nga lloji i rrugëve, numri i shiritave të rrugës, lloji i shiritave (për automjete, për këmbësorë, për biciklist, shiritat gjelbrues,..), nga dendësia e trafikut, etj... Ajo qka duhet respektuar është intensiteti i ndriçimit që duhet të sillet nga (20-30)lx dhe njëtrashmëria e ndriçimit që nuk mund të kaloj kufirin 1:3. Trupat ndriçues që të gjithë duhet të jenë LED.

Kabllat e ndriçimit do të kalojnë nëpër të njëjtin kanal me kablla energjetike të rrjetit 0.4kv. Furnizimi për ndriçim të rrugëve do të mirret nëpër TS-t e parapara për furnizim të objekteve. Këto trafostacione duhet të kenë një kthinë të veçant për vendosjen e paisjeve për matje të energjisë dhe paisjeve për komandim të ndriçimit.

5. Planifikimi i sistemit të Telekomunikimit

Sot dhe për të ardhmen ashtu siq është kërkuar me rekomandimet e IEC-s sistemi i telekomunikimit për medium transmetimi duhet të ketë fijet optike të cilat e kanë mundësinë e transmetimit të sinjalit shumfish më të madhe madje të pakrahasueshme me fijet e bakrit.

Për bartje të linjalit telekomunikues dhe shpërndarje të tij deri te banorët janë paraparë dy centrale telefonike periferike CP1 dhe CP2. Këto centrale do të lidhen me qendren postare të qytetit përmes kabllit optik 24 fijorë të tipit ‘Singel Mode’, pra secili central me nga një kabëll. Shpërndarja e mëtutjeshme bëhet me kabëll të njëjt por me 12 fije deri te kutitë fundore të kabllit optik.

Shpërndarja nga centralet periferike deri te kutitë fundore do të jetë yllore-serike. Kjo do të thotë se do të kemi disa dalje nga centrali dhe në secilën dalje nga disa kuti të lidhura në seri njëra pas tjetres. Centrali CP1 do të ketë tri dalje ndërsa CP2 vetëm një dalje për këtë projekt, por mund të përdoren dalje tjera për pjesë tjera të asaj zonë. Një central periferik ekziston edhe në qendren spitalore dhe nga ai daljet vazhdojnë drejt e nëpër spitale. Pra nuk është parapa ndryshim i gjendjes ekzistuese. Në rast ndërtimeve të reja centrali ka kapacitete të mjaftueshme për zgjerim. Kutitë fundore që janë të vendosura nëpër lagje kanë mbrojtje mekanike IP65 dhe vendosen në bazamente betoni. Në këto tabela do të vendosen paisjet për shëndërrim të sinjalit nga ai optik në sinjal elektrik apo nga optik në optik gjegjësisht nga sinjali optik në single mode në ate multi mode.

Nga këto kuti deri te objektet gjegjëse sinjali vazhdon nëpër kablla optike multi ose kablla të NET-it varsisht nga nevoja dhe madhësia e objektit. Të gjitha këto pastaj do të jenë pjesë e projekteve të veqanta për raste veq e veq.

Këto kablla do të shkojnë nëpër të njëjten trasë me kabllat energjetike, por duhet të vendosen në gypa të ndryshëm, pra jo në të njëjtin gyp me kablla energjetike.

Pjesë e këtij plani është edhe një hartë në të cilën është dhënë trasa e kabllës optike dhe vendet e centraleve e të tabelave shpërndarëse të sinjalit telekomunikues në distance të njëjt ndaj saj dhe gjatë tërë gjatësisë së saj.

fig.1 Pamja e kanalit kabllovik Shirit i zinkuar Fe/Zn 25/4mm² Rëra Gyp i brinjezuar F125 Mbrojtje e plastikes Shiriti i verejtjeve Dhe i ngjeshur 1. Kabëll energjetike 0.4kV 2. Kabëll energjetike XHP 20kV 3. Kabëll STP cat6 4. Kabëll optik

6. Udhëzime teknike për projektuesit dhe kryesit e punve

Meqense ky projekt nuk është projekt zbatues por do të jetë projekt udhërrefyes për projektet zbatuese e shoh të arsyeshme që ti theksoj disa nga rregullat teknike dhe disa nga kërkesat e këtij projekti për projekte zbatuese.


Të gjitha trafostacionet e reja janë parapa të vendosen në shtëpiza betony ose të tipit blindë të cilat në brëndësi duhet të kenë hapsirë për vendosje nga 400kVA deri në 1250kVA.

Vendi ku do të vendosen TS-t duhet të ketë hapsirë të nevojshme për qasjen e makinerisë për

ngarkim-shkarkim dhe vendosje të trafostacioneve

Hapsira ku do të vendoset Trafostacioni duhet të jetë gjithashtu e mjaftueshme për të realizuar ndërtimin e përtokzimit mbrojtës dhe të punës së trafostacionit.

Ndërtimi i trasave të reja kabllore duhet bërë kryesisht përgjat rrugëve në kanal in e ndërtuar sipas vizatimit të dhënë në fig.1. Nga një kanal i tillë duhet të ndërtohet në të dy anët e rrugës në distance të njëjt ndaj saj dhe gjatë tërë gjatësisë së saj.



Pusetat e tilla duhet të vendosen në çdo vend kryqzim apo degzim të kabllave.

Gjatë 10 viteve të ardhshme sa zgjatë ky plan trasat e kabllave duhet të ndërtohen parallel me ndërtimin e rrugëve i cili është parapa në këtë plan. Ky ndërtim i trasave duhet të bëhet pavarësisht se a kërkohet në at moment edhe vendosja e kabllave. Në këto raste vendosen vetëm gypat e brinjëzuar, ndërtohen pusetat ndërsa kabllat vendosen atëhere kur paraqitet nevoja.

Gjatë vendosjes së kabllave në gypa, kabllat 10(20)kV, ato 0.4kV, kabllat e tensionit të ulët dhe kabllat optike vendosen në gypa të ndryshëm e kursesi në të njëjtin gyp.

Nuk lejohet vendosja paralele në të njëjtin kanal, nën kanal ose mbi kanal, të kanaleve të instalimeve të ujit, nxemjes, kanalizimit fekal, gazit etj...

Vendosja paralele e trasave të kabllave dhe trasave të instalimeve tjera duhet t'i rrespsktoj distancat teknike.

Lejohet kryqzimi i trasave të kabllave dhe instalimeve tjera por distance minimale e tyre duhet të jetë më e madhe se 0.3m dhe këndi i kryqezimit 90°.

Me këtë plan është parapa që ndriqimi i rrugëve dhe shesheve të jetë i vendosur në shtylla metalike me bazamente të betonit.

Lartësia e shtyllave dhe distance në mes tyre duhet të llogaritet në bazë të sasisë se ndriqimit që synohet të ketë në vendet gjegjese.

Te rrugët të cilat në mes kanë shirit të gjelbër, llampat duhet të vendosen në hapsirën e gjelbër dhe do të jenë dykrahëshe ndërsa në rrugët tjera vendosen në pjesët ansore.

Në rrugët ku ndiqimi do të bëhet nga pjesët anësore trasa e kabllave të ndriqimit duhet të jetë në të njëjten trasë me kabllat tjera.

Shiriti përtokzues i trases së kabllave duhet të shërbej edhe për përtokzimin e shtyllave tëndriqimit.

INSTALIMET MAKINERIKE

SISTEMI I RRJETIT PËR FURNIZIM ME ENERGJI TERMIKE NË LARGËSI TË NGROHJES QËNDRORE PËR PLANIN

Projekti kryesorë i instalimit të rrjetit për furnizim me energji termike në largësi, të ngrohjes, për planin, rrjeti i furnizimit me energji termike në largësi është punuar, në bazë të shënimeve dhe planeve si dhe në bazë të kërkesave specifike për ndërtesat në veqanti.

Sistemi i ngrohjes është paraparë me ujë të tejnxeur me nënstacione termike me kapacitete adekuate të kalkuluar për ndërtesat afariste banesore ndërtesat shkollore si dhe shtëpitë e banimit.

Rrjeti për furnizim me energji termike është paraparë të ndërtohet me tuba të paraizoluar termikisht dhe hidralikisht.

Në vendet e kyqjes, degëzimeve të sistemit të rrjetit gypor për shpërndarje të veqanta të parashihen pusetat e betonit me dimensione adekuate.

Në fillim të çdo kyqje në rrjetin shpërndarës të vendosen valvulet dalëse dhe kthyesë të ujit të tejnxeur në sistemin shpërndarës për vazhdimin e sistemit të rrjetit, të parashihen gypat e paraizoluar me dimensione adekuate.

Në puseta parashihen edhe valvola automatike për largimin e ajrit nga sistemi i rrjetit gyporë dhe mbushje zbrazjes të sistemit.

Projekti është përpiluar në tërësi në harmonin me normat dhe standardet në fuqi të Rrepublicës të Kosovës dhe normave Evropiane, për sistem të instalimeve të energjisë termike në largësi.

TUBACIONET

Dimensionimi i tubacioneve të furnizimit me energji termike në largësi për ndërtesat e banimit dhe afariste, me parametra të ujit të tejnxeur të marura nga “Termokosi” 130/70°C. Kalkulimet e bëra të përafërta me ndërtesat sipas projektit të dhënë afërsisht 30Ë/m³.

Gjatë instalimeve të tubave në tokë duhet pasur kujdes nga ujrat nëntoksor. Tubacionet e paraizoluara duhet të jenë të punuara nga shkuma e poliuretanit. Këto tubacione duhet të kenë

atestet dhe çertifikatat e kualitetit të materialit.

Shtrirja e tubacioneve të jetë minimum nën shtresën e tokës $h=1.5\text{m}$.

I tërë sistemi i instalimit të rrjetit duhet të punohet sipas dokumentacionit të projektit detal, ndërsa materialet të jenë të klasës së parë dhe komfort standardeve të BE-së dhe Kosovës të pajisura me çertifikata dhe ateste të kualitetit të materialeve.

Tubacionet qendrore të vendosen në lokalitetet me dendësi më të madhe të ngarkesës termike, në mënyrë që shpenzimet e transportit të nxehtësisë të jenë sa më të ulëta. I kemi marrë parasysh pozitën, nivelet dhe pjerrtësitë e terenit. Si dhe në projekt shihet se dimensionimi i gypave rajonal për këtë zonë dhe për shkak të pjerrtësisë së Regjionit të këtij vendbanimi në gjatë projektimit na u është kërkuar që rrjeti i tubacioneve të ndahet në tre degë kryesore të furnizimit, në këtë vendbanim degët kryesore do të kenë tubacione me diametër nominal nga DN100 deri tek DN250 që duhet furnizuar vendbanimi po ashtu dy degët tjera të vendbanimit parashihen të furnizohet me DN100 deri tek DN300. Furnizimi i të gjithë objekteve mbulohet me këta tuba të ngrohjes që vije nga termokosi deri tek nënstationet termike që me pas nga nënstationet termike çdo ndërtesë objekt shkollor apo edhe shtëpi banimi do të kyqen me rrjet lokal të dimensionuar me diametër minimal nga DN65 e deri tek DN100 ku këta tuba janë të paraizoluar dhe të kenë të kryer A-testin që ju kërkohej sipas standardeve dhe të jetë e pranueshme për projektin në fjalë.

ENERGJIA E NEVOJSHME PËR NGROHJE

Duke pasur parasysh se llogaritja e nevojave për furnizim me energji termike në largësi për një kompleks të banesave ose ndërtesë afariste, për një lagje apo qytet, është një llogaritje mjaft e ndërlikuar, për të cilën duhet të dihen shumë parametra dhe të merren parasysh shumë të dhëna, në vijim do të japim një përshkrim shumë të shkurtër dhe të përafërt për metodën e kalkulimit.

Për caktimin e saktë të shpenzimeve të energjisë për ngrohje në ndërtesë afariste dhe ndërtesat e banimit kemi përdorur standardin Evropian EN 12831, për sistemin e furnizimit me energji termike në largësi kemi përdorur llogari sipas DIN.

- Për ndërtesat e banimit, me etazhitet deri në 7 kate, është $120\text{€}/\text{m}^2$

- Per ndërtesat e banimit, me etazhitet prej 8 deri në 9 kate, është 110Ë/m²

Për përcaktimin e saktë të kapaciteteve për ngrohje dhe të sasisë së energjisë së nevojshme, duhet të trajtohen me saktësi edhe këta faktorë:

- Sipërfaqja e saktë e ndërtesave
- Lloji i ndërtesave
- Madhësia e ndërtesave
- Mundësia e ngrohjes së ndërtesave
- Planifikimi i kriterëve termike për ndërtesat që do të ndërtohen dhe,

Projekti kryesorë i instalimit të rrjetit për furnizim me energji termike në largësi është punuar në bazë të shenimeve dhe vizatimeve të marra nga arkitektura dhe kërkesat e investitorit. Tubacioni do të realizohet në atë mënyrë siq është dhënë në përshkrim teknik dhe në dokumentacionin grafik.

Për punimin e tubacionit përdoren gypat e paraizoluar. Vendet e salduara duhet të jenë të punuara mirë me trashësi të mjaftueshme të shtresës së saldimit kështu që diametri i gypit në mos ndryshojë.

PUSETAT

Pusetat sipas funksionit parashihen për:

- a. Pajisjet për mbyllje dhe pajisjet matëse,
- b. Ajrosje dhe zbrazje,
- c. Hyrja në nënstacione në ndërtesë,
- d. Kontrollë të rrjetit,
- e. Ndërprerjen e ujit në raste të avarive të paraqitura,

Pusetat duhet të ekzekutohen sipas standardeve dhe normave në atë mënyrë që gjatë intervenimeve të mundëshme ekipet e mirëmbajtjes të punojnë pa pengesa siq edhe organizohen gjatë gjithë rrjetit të tubacionit në këtë vendbanim siq edhe parashihet në projektin ideor ku edhe shihet mënyra e organizimit të këtyre pusetave.

ZBRAZJA E SISTEMIT TË RRJETIT

Në pikat më të ulëta në mes të dy valvoave mbyllëse të sistemit, duhet të vendosen valvulat për zbrazje të rrjetit.

Nëse sistemi i rrjetit të ujit të tejnxehur, që shkarkohet në kanalizim, atëhere nuk duhet lejuar që temperatura e ujit të nxehtë të kalojë 35°C , këtë duhet arritë, duhet përzier ujin e tejnxehur me ujë të ftohtë.

Muret duhet të jenë rezistues ndaj zjarrit dhe duhet të kenë një shtresë për mos lejimin e depërtimit të gazrave. Materiali i dyshemesë dhe tavanit duhet poashtu të jetë rezistent ndaj zjarrit.

Në dhomat teknike të secilit objekt rrjeti organizohet gjerë në këmbyes ku bëhet ndarja e rrjetit. Uji i dërgimit të termokosit ku këmbëhet në këmbyesin e nxehtësis dhe këmben nxehtësin e fluiditë i cili qarkullon me pompa në objekt. Hapjet për tubat në murë në dysheme në tavan ose tubacione të tjera për ujë sanitar të ngjashme, duhet të bëhet izolimi me material elastike të cilat nuk lejojnë depërtimin e gazrave.

Te instalimet me lëndë djegëse të gazëta, njëri murë duhet të jetë murë i mbrojtur nga eksplodimi nga qelqi i gurit.

AJROSJA E RRJETIT MAGJISTRAL

Të gjitha pikat më të larta të sistemit magjistrat, kërkojnë që në çdo kohë, të këtë qasje për kryerjen e ajrosjes së rrjetit, të kryhet me anë të valvolave në mënyre automatike.




Fig.17. Detali i kanalit, kanali ne kthesa dhe detali i saldimit .

Ngrohja-Shtrirja e Rrjetit të tubacinit

Verejtje:

Për dimensionimin e gypave të ngrohjes duhet vertëtuar pasi që të bëhet llogaria perfundimtare e gypave në bazë të projektit kur do të fillohet me punen finale të projektimit, nga aty ne do të shohim nëse duhet zëvendësuar gypat me dimensione tjera më të mëdha apo më të vogla për arsye se organizimi i të gjithë hapsirave banuese nuk është e percaktuar për të ditur në menyrë më të perafërt dimensionimin e gypave te ngrohjes për keto hapsira.

RRJETI I UJËSJELLESIT DHE KANALIZIMIT

Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Llogaritja e shpenzimeve të ujit.

Koncepti i frunizimit me ujë dhe sasit e nevojshme.

Duke e ditur destinimin e sipërfaqes sipas planit që do të hartohen dhe numrit të banorëve do të llogaritet sasia e nevojshme e ujit për shtëpi dhe objekte të tjera.

Sistemi i furnizimit me ujë do të bëhet nga rrjeti i ujësjellesit rajonal Prishtina i cili është planifikuar me projektin rregullativ urban të Prishtinës. Sistemi shpërndarës i rrjetit të gypave .

Sistemi shpërndarës i rrjetit të gypave për rrjetin e ujësjellësit, të kanalizimit fekal dhe atij atmosferik është planifikuar të vendoset kryesisht nëpër trotuare ose në rrugë.

KONCEPTI I ZGJIDHJES SË PROBLEMIT PËR FURNIZIM ME UJË DHE NEVOJAT PËR UJË TË PIJES

Projekti është përgaditur në bazë të kërkesave për ujë të pijes për 31000 banorë , si dhe kërkesave të investitorit të lagjes “Prishtina e re” duke e marrë për bazë planin zhvillimor të kësaj lagje në perspektivë.

LLOGARITJA E HARGJIMIT TË UJIT

PERIUDHA PROJEKTUESE DHE NUMRI I BANORËVE

Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit kërkon shpenzime të mëdha, prandaj duhet pasur kujdes në përcaktimin e diametrave të tubave të rrjetit të ujësjellësit. Këto diametra varen nga prurjet llogaritëse, sasia e të cilave varet direkt nga numri i banorëve të qendrës së banuar gjerë në periudhen e projektuar.

Për të bërë llogarin hidraulike për sistemin e ujësjellësit së pari duhet të sigurohet numri i saktë i banorëve. Numri i banorëve i mometit është llogaritur 31000 banorë. Llogaria është bërë për 30vitet e ardhshme me koeficient të shtimit 2%.

Përvetësohet numri i përgjithshëm i banorëve në $N_b = 31000 \text{ banorë}$

Materiali i rrjetit të ujësjesit është si në vijim:

Fi 110 mm gypi HDPE PN 16

Fi 160 mm gypi HDPE PN 16

Fi 250 mm gypi HDPE PN 16

Fi 310 mm gypi HDPE PN 16.

Ketu do të kemi parasysh dhe Hidranta që do të vendosen konform rregullave dhe standardeve në fuqi dhe ku e kërkon nevoja gjatë projektimit.

ANALIZA E HARGJIMIT TË UJIT

Për caktimin hargjimit të ujit për këtë sistem nuk do të mirren parasyshë koficientët e hargjimit të ujit për pastrimin e rrjetit dhe për pastrimin e ujit për impiant ngase sistemi i ujësjesit është paraparë të jetë pa impiant pastrimi duke i shfrytëzuar ujrë nëntoksorë.

Sipas normave aktuale në fuqi për projektimin e sistemeve të ujësjesit për vendbanime urbane norma e hargjimit ditor për një banor është $q=180 \text{ l/b/dit}$.

Kof. i sigurisë $K_d=1.3$; $K_0=1.5$; $K_p=1.5$ koficienti i jonjëtrajtshmerisë.

$$Q_{dit}^{mes} = N_b^{30} \times q = ..l / dit$$

$$Q_{dit}^{max} = Q_d^{mes} \times k_1 = ..l / dit$$

$$Q_{or}^{mes} = \frac{Q_d^{mes}}{24} = ..l / or$$

$$Q_{or}^{max} = \frac{Q_{or}^{mes}}{24} \times k_0 = ..l / or$$

$$Q_s^{mes} = \frac{Q_{dit}^{mes}}{86400} = l / s$$

$$Q_s^{max} = \frac{Q_{dit}^{mes}}{86400} \times k_p = l / s$$

Sasia prej Q=67.78 l/s merret për llogari.

KANALIZIMI FEKAL (SANITARË)

Kanalizimi fekal grumbullon ujërat sanitare të cilat vijnë nga objektet e banimit, objektet afariste, komerciale, shoqërore etj. Gjatë dimensionimit janë marrë parasyshë numri i objekteve të banimit dhe numri i banorëve, gjithmonë duke u bazuar në gjendjen faktike në teren si dhe duke u ndihmuar nga orto-photo.

Në përbërje të kanalizimit fekal hyjnë edhe pusetat reviduese të cilat janë vendosur në distanca të caktuara varësishtë nga përshtatshmëria e pozicionit. Distanca në mes të pusetave nuk kalon 50 m’ njëra nga tjetra, distancë kjo e lejuar me norma të projektimit. Pusetat janë të ndërtuara prej unazave të gatshme montuese nga betoni Ø 1000 mm, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.

Ø 250 mm m’

Ø 280 mm m’

Ø 315 mm m’

Ø 400 mm m’

Ø 560 mm m’

Ø 630 mm m’

Ø 800 mm m’

Ø 900 mm m’

KUSHTET E NDËRTIMIT

PUNËT E DHEUT

Gërmimi i kanalit për vendosjen e gypave duhet të bëhet sipas udhëzimeve në projekt dhe gjithëherë duhet të kemi parasysh rregulloret në fuqi mbi mbrojtjen në punë, përkarësisht përforsimi me pahi i pjesëve anësoreve të kanalit mbi thellësinë 2,00m'. Me përforsim obligativ përgjatë trases..

Sipas rregullores në fuqi duhet të respektohen thellësit prej :

- min 0,8m në vende ku nuk ka qarkullim të komunikacionit.
- min 1,0 m për vendet ku kemi komunikacion prej 12t për gjatë trasës së kanalit.
- min. 1,5 m për vendet ku kemi komunikacion prej 20t për gjatë trasës së analit.

Gjerësia e kanalit varet direkt prej dimensioneve të gypave që do të vendosen në atë pjesë të kanalizimit, por patjetër duhet të respektohen kriteri min. d+40cm. Para vendosjes së gypit duhet të bëhet planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit për caktimin e pjerrësis së kërkuar sipas projekti

- **Ngjeshja e dheut në kanal**

Pas vendosjes së gypave në kanal dhe kontrollit teknik nga mbykqyrësi profesional i punimeve në punishte, kanali duhet të mbulohet dhe njëkohësisht duhet të bëhet ngjeshja me dorë deri në shtresën 30 cm mbi gyp.

Duhet të kihet kujdes në mbulimin e gypit meqenëse nuk guxojm të përdorim dheun e lagur apo dheun me karakteristika të lidhjes së fortë si të argjirës për shkak të mundësis së paraqitjes së deformimeve në gyp. Mbulimi i kanalit duhet të bëhet me zhavor, në mënyrë që mos të kemi ulje në vijën e kanalit. Ky llojë zhavori duhet të ketë karakteristika të mira ngase shërben njëherit edhe si izolator i gypit, prandaj para për përdorimit të këtij lloji zhavori duhet që qdo herë të muret leja përkatëse.

Poashtu rëra të cilin e përdorim për mbulim të gypit në kanal nuk guxon të ketë gurë të madhësis mbi 20mm.

Ngjeshja e dheut me makineri preferohet mbi shtresën 30cm mbi gyp edhe atë duke e përsëritur në çdo 20cm deri në sipërfaqen e terenit.

RREGULLIMI I FUNDIT TË PUSETËS

Pas zgjerimit të vendit ku planifikohet të ndërtohet puseta bëhet përpunimi i fundit të pusetës kontrolluese me MB-20 (për realizimin e kinetave). Trashësia (lartësia) mesatare e fundit është 30 cm. Këto funde shërbejnë si bazë për vendosjen e pusetave.

VENDOSJA E PUSETAVE

Pusetat përbëhen prej unazave të gatshme montuese nga betoni i armuar Ø 1000 mm, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.

Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit me shpuarjen e zbrastësirave, të gjitha këto janë punë përcjellëse për realizimin e një pusete.

Për vendosjen e gypave të kanalizimit, duhet të bëhet lidhja e gypave me llaq çimentoje.

Për secilën pusetë është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø 1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000 mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të të cilit montohet korniza me kapakun e rëndë, ndërsa unaza e poshtme mund të shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusetës.

PUNËT METALPUNUES

VENDOSJA E KAPAKËVE TË PUSETAVE

Pusetat duhet të mbulohen kapakë të hekurtë, për ngarkesa të rënda komunikacioni Ø 700 mm, tipi RP 252, me kornizë, i rëndë. Kornizën duhet betonuar në unazë të betonit MB-25 me dimension 0,25x0,25.

Shkallët metalike

Shkallët metalike do të punohen nga shufrat metalike me diameter $\Phi 20\text{mm}$ të butë, të lakuar dhe të galvanizuara. Shkalla do të jetë 200mm distancë nga muri (shih detalin e pusetës). Ato duhet të instalohen në mur në thellësi 100mm dhe fundet duhet të jenë të kthyer për 90°. Varësisht nga direktivat e inxhinierit, hapësira mes shkallëve do të jetë 300mm në interval vertikal.

KANALIZIMI ATMOSFERIK

Uji atmosferik grumbullohet përmes ujëmbledhësave rrugorë, përmes këtyre ujëmbledhësave uji depërton në pusetat kontrolluese nga betoni i armuar dhe më pas gypat transportues e bëjnë evakuimin e ujit atmosferik në kanalizimin qëndrorë.

Pas dimensionimit të rrjetit të kanalizimit atmosferik kemi përvetësuar ujëmbledhësa rrugorë me dimensione: $h/b = 460/360\text{ mm}$, si dhe puseta nga betoni i armuar. Pusetat janë të ndërtuara prej unazave të gatshme montuese nga betoni $\Phi 1000\text{ mm}$, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.

$\Phi 250\text{ mm}$	m'
$\Phi 280\text{ mm}$	m'
$\Phi 315\text{ mm}$	m'
$\Phi 400\text{ mm}$	m'
$\Phi 560\text{ mm}$	m'
$\Phi 630\text{ mm}$	m'
$\Phi 800\text{ mm}$	m'
$\Phi 1000\text{ mm}$	m'

Kushtet e ndërtimit janë cekur me lartë në kanalizim fekal.

Verejtje:

Për dimensionet e gypave duhet vërtetuar pasi që të bëhet llogaria perfundimtare e gypave në bazë të projektit kur dhe do të fillohet me punën finale projektuese, aty do e shohim nëse duhet zëvendësuar me gypa me dimensione më të mëdha apo më të vogla. Kjo vlen për të tri rrjetet : ujësjellësi, kanalizimi fekal si dhe atij atmosferik.